

## AKT THEMELIMI

### I QENDRËS "SUADA"

Sot më datë 20.10.2017, në Tiranë, u paraqitën përpara meje noter Admir Drago, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me studio në Rruga Andon Zako Cajupi, Tiranë, personi juridik publik i mëposhtëm:

- Shoqata "Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve", e përfaqësuar nga Presidenti i saj Z. Zamir Sukniqi, me adresë Rr. Andon Zako Cajupi, Tiranë.
- Shoqata "ALBAUTOR" e përfaqësuar nga Drejtori i saj Z. Erlir Puto, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", nr. 114, kati 2, Tiranë.

Të cilët, në cilësinë e themeluesit të Qendrës "SUADA" (Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit), nënshkruan në praninë time këtë Akt Themelimi:

## AKT THEMELIMI

### I QENDRËS "SUADA"

#### Neni I

"Qendra "SUADA" është një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësi. Emri i saj është sinkronim i Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit - SUADA

#### Neni II

Selia e Qendrës është në Tiranë, Rr. Andon Zako Cajupi, Tiranë.

#### Neni III

Kohëzgjatja e Qendrës është e pakufizuar, dhe pasuria fillestare e qendrës është në vlerën prej 1 (një) mijë lekë, të derdhura në llogari bankare nga personi i autorizuar për regjistrimin e Qendrës.

#### Neni IV

Objekti i kësaj qendre është:

- a) Kryerja e aktiviteteve promovuese dhe fushatave të ndërgjegjësimit për njohjen dhe



respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në Republikën e Shqipërisë;

- b) Të kryejë promovimin e vlerave të krijimtarisë intelektuale dhe artistike, edukimin e brezave të reja si dhe cdo veprimtari tjetër në funksion të mbrojtjes së të drejtës së autorit në Shqipëri.
- c) Kryerja e funksionit të mbledhjes të tarifave të shpërblimit nga përdorimi i veprave të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet përdorues, si një sportel i vetëm në emër të të gjitha agjencive të administrimit kolektiv të licencuara, si dhe shpërndarjen e këtyre të ardhurave tek këto agjenci në përputhje me ligjin 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura", udhëzimin nr. 663 datë 10.10.2017 i Ministrit të Kulturës "Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv", vendimin nr. 4, datë 10.10.2017 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit.
- ç) Kryerja e të gjitha veprimeve dhe aktiviteteve për zbatimin e parashikimeve të këtij neni.

#### Neni V

Qëllimi kësaj qendre është:

- a) të kryejë aktivitete formuese edukimi dhe sensibilizimi duke ofruar edhe konsulencë të specializuar për të tretët;
- b) të krijojë logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme me synim kryerjen e veprimtarisë së kësaj qendre.
- c) të përfaqësohet në organizata apo ente publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për bashkëpunim reciprok dhe intensifikimin e eksperiencave dhe praktikave me të mira të fushës;
- ç) të publikojë studime, broshura, libra dhe revista, të cilat kontribuojnë në sensibilizimin e grupeve të interesit dhe subjekteve përdorues mbi kuadrin rregullator të të drejtave të autorit në Shqipëri;

#### Neni VI

Subjekte themelues të qendrës Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit - SUADA janë personat juridikë si më poshtë vijon:

- Shoqata "Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve", e përfaqësuar nga Presidenti i saj Z. Zamir Sukniqi, me adresë Rr. Andon Zako Cajupi, Tiranë.
- Shoqata "ALBAUTOR" e përfaqësuar nga Drejtori i saj Z. Erlir Puto, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", nr. 114, kati 2, Tiranë.

#### Neni VII

Organet drejtuese të qendrës janë:

- Bordi i Drejtorëve;
- Drejtori Ekzekutiv.

#### Neni VIII

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha agjencive të licencuara si më poshtë:

- Z. Zamir Sukniqi, përfaqësues i Agjencisë së Mbrojtjes së Procudentëve;
- Z. Erlir Puto, përfaqësues i Agjencisë ALBAUTOR;
- Z. Naim Aliaj, përfaqësues i Agjencisë AKDIE;
- Z. Esat Musliu, përfaqësues i Agjencisë FMAA.

Drejtori Ekzekutiv i qendrës është Z. Zamir Sukniqi përfaqësues i Agjencisë së Mbrojtjes së Procudentëve.

#### Neni IX

Për regjistrimin e Qendrës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe pranë organeve të tjera kompetente shtetërore ngarkohet për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme Z. Zamir Sukniqi.

Lexuar, pranuar dhe nënshkruar

Tiranë, më 20/10/2017

#### THEMELUESIT

Shoqata "Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve" President Zamir Sukniqi

Shoqata "ALBAUTOR" Drejtori Erlir Puto

